


**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

# Arsimimi

**KULTURA E NJERIU***Ë-buletin***Gusht, 2020**

Nga takimi me Këshillin Drejtues dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal

**Doli propozimi që u pranua edhe nga institucionet shtetërore**



Të enjten e javës së kaluar është mbajtur takimi nga larg i Këshillit Drejtues dhe i kryetarëve të nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve me qëllim që të analizohen përgatitjet e bëra në institucionet arsimore lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri u kanë treguar pjesëmarrësve të këtij takimi lidhur me të gjitha angazhimet e SBASHK-ut gjatë...(faqe 4)

SBASHK-u ka vazhduar takimet me përfaqësues të institucioneve


**Takime të ndara me zv/kryeministrin Selmanaj dhe zv/ministrin Rexhaj**



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm ...(faqe 7)

SBASHK-u vazhdon të realizojë kërkesat e anëtarësisë


**U fillua me ciklin e ri të trajnimeve nga larg**



Koordinatori për organizim të brendshëm...(faqe 7)

*Intervistë me kryetarin e Kuvendit të Arsimit Parauniversitar të Prishtinës*

**Ahmet Pllana krenar me angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut... (faqe 3)**



Bashkëpunim korrekt mes SBASHK-ut dhe MASH-it

**Tema të bashkëbisedës çështjet aktuale në arsim**



*Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë pasur komunikim të vazhdueshëm nga larg me ...(faqe 5)*



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures  
The Union of Education, Science and Culture

## Editorial

### Shtatori me plot sfida



Gjatë gjithë gushtit temë bisede ishin opsionet e dala nga MASH-i lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor. SBASHK-u po analizonte me kujdes këto opsione dhe në komunikim me anëtarësinë doli publikisht me vlerësimin se mësimdhënësit e Kosovës janë për t'u kthyer në institucionet arsimore, por për këtë duhen bërë përgatitje me qëllim që të mbrohet shëndeti i nxënësve dhe punëtorëve arsimor.

SBASHK-u ka mbajtur takime nga larg dhe komunikim të rregullt me kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të Universiteteve dhe me anëtarë të Këshillit Drejtues duke analizuar në mënyrë korrekte përgatitjet që janë bërë në institucionet arsimore lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor. Sfidat e shumta janë paraqitur me t'u afruar shtatori. Ky vit shkollor do të jetë nga më të vështirët dhe nga më sfiduesit sepse po përballemi me një armik që nuk shihet, por që është tepër i rrezikshëm dhe nuk fal. Prandaj për t'i mbrojtur nxënësit e punëtorët arsimor nga ai duhet angazhim maksimal i të gjithëve. Angazhim që do vazhduar, jo një ditë e dy, por me javë e muaj të tërë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)**

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +383(0)38/ 226 940



## Intervista

Intervistë me kryetarin e Kuvendit të Arsimit Parauniversitar të Prishtinës

### Ahmet Pllana krenar me angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut



*Me një zë të qetë e duke dhënë shembuj konkret të angazhimit, përkushtimit e korrektësisë Ahmet Pllana krijoi respekt meritë nëpër vite e dekada edhe si drejtues i institucionit arsimor,*

*por edhe si udhëheqës sindikal. Me shembullin e tij prej pedagogu e sindikalisti ka bërë që të shtohen aktivitetet sindikale në kryeqytet. Ai në këtë intervistë flet për aktivitetet e zhvilluara, por edhe për angazhimet që do të bëhen në shërbim të anëtarësisë në Prishtinë e kudo në Kosovë.*

#### Arsimimi sot:

Kush është Ahmet Pllana?

#### Ahmeti:

Tani jam mësimdhënës në shkollën “Dardania”. Në këtë institucion të respektuar arsimor e edukativ më lidhin kujtimet nëpër vite e dekada. Shpesh kujtoj edhe vitet e okupimit dhe sfidat e mëdha, por edhe qëndresën dhe sakrificat e gjithë personelit arsimor në mbrojtjen e arsimit shqip. Kolegët e mi sindikalistë me zgjodhën që të drejtoj Kuvendin Sindikal të Arsimit Parauniversitar të kryeqytetit. Ishte ky një nder, por kërkohej edhe angazhim e përkushtim i vazhdueshëm. I përkrahur nga kolegët e mij nga gjithë shkollat e Prishtinës dhe nga stafi qendror kemi arritur të shënojmë suksese të shumta në realizimin e kërkesave të anëtarësisë.

#### Arsimimi sot:

Cilat janë vlerat e larta të SBASHK-ut sipas jush?

#### Ahmeti:

SBASHK-u ka krijuar nëpër vite vlera dhe ka krijuar po ashtu me punë, angazhime e përkushtim edhe emër të respektuar. Vlerë e madhe e SBASHK-ut është uniteti, respekti e besimi i krijuar me punë e

angazhime të vazhdueshme. Vlerë e lartë është edhe fakti se në SBASHK vendimet merren pas bashkëbisedave në takimet e Këshillit Drejtues dhe me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve dhe me anëtarësinë kudo janë. Vlerë është sepse SBASHK-u ishte dhe mbetet zë i anëtarësisë dhe prandaj gëzon besim të plotë të tyre.

#### Arsimimi sot:

Përveç angazhimeve të shumta në të kaluarën dhe tani, çfarë do të veçonit ju?

#### Ahmeti:

SBASHK-u ka zhvilluar shumë aktivitete dhe me mund e sakrifica të përbashkëta dhe falë unitetit shembullor ka arritur të realizojë shumë prej kërkesave të anëtarësisë. Këto arritje janë të njohura edhe për opinionin e gjerë. Unë do të veçoja një aktivitet, nga aktivitetet e shumta të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. E kam fjalën për organizimin e suksesshëm të trajnimeve të licencuara, që janë mbajtur e vazhdojnë të mbahen sipas kërkesave të anëtarësisë. Edhe në komunën tonë ky aktivitet ka zgjuar interesim shumë të madh dhe edhe në ciklin e ri që filloi këtë të shtunë janë paraqitur një numër i madh i kolegëve të mij nga Prishtina dhe janë pjesë e katër trajnimeve të licencuara të SBASHK-ut. Për këtë falënderoj stafin qendror, kryetarin Jasharaj dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

#### Arsimimi sot:

Çka do të shtoni në fund të kësaj interviste?

#### Ahmeti:

Ta ruajmë unitetin dhe të punojmë e angazhohemi me stafin qendror dhe gjithë anëtarësinë. Arsimin po e presin sfida të mëdha dhe prandaj na duhet uniteti dhe angazhimi e përkushtimi i vazhdueshëm në shërbim të anëtarësisë.


Nga takimi me Këshillin Drejtues dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal

### **Doli propozimi që u pranua edhe nga institucionet shtetërore**

Të enjten e javës së kaluar është mbajtur takimi nga larg i Këshillit Drejtues dhe i kryetarëve të nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve me qëllim që të analizohen përgatitjet e bëra në institucionet arsimore lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor.




Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri u kanë treguar pjesëmarrësve të këtij takimi lidhur me të gjitha angazhimet e SBASHK-ut gjatë muajve të verës dhe për komunikimin dhe takimet e mbajtura me përfaqësues të lartë të institucioneve të Republikës së Kosovës.



Pas kësaj kryetarët pjesëmarrës në këtë takim të nivelit komunal sindikal kanë treguar për gjendjen në institucionet arsimore në komunat e tyre dhe për përgatitjet që janë bërë për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor. Ata kanë deklaruar se personeli arsimor

dhe tekniko-ndihmës shprehin vullnetin për të nisur mësimin në objektet shkollore duke përkrahur në këtë mënyrë masterplanin e MASH e të miratuar nga Qeveria, por numri më i madh i pjesëmarrësve kanë shprehur shqetësimin se shkollat ende nuk janë përgatitur për të nisur vitin e ri shkollor sipas kushteve të parapara për masat mbrojtëse dhe planit të MASH-it. Duke argumentuar ata kanë përmendur se pjesa më e madhe e shkollave ende nuk është dezinfektuar, dhomat e mësimi nuk janë pajisur me dezinfektues për duar, nuk janë siguruar maskat mbrojtëse për personelin arsimor, nuk është përgatitur lista e mësimdhënësve rezervë për të zëvendësuar mësimdhënësit e sëmurë e as nuk është shpallur ndonjë thirrje a konkurs për mësimdhënës vullnetar, nuk janë përgatitur dhomat e mësimi për të siguruar distancën e duhur sociale, por nuk janë bërë edhe përgatitje të tjera brenda ambienteve shkollore. Nga ana tjetër SBASHK-ut kanë nisur t'i vijnë informacione se ka tendenca nga ndonjë DKA dhe ndonjë drejtor shkolle që mjetet higjienike dhe dezinfektuesit t'i sigurojnë përmes prindërve, qoftë duke mbledhur para nga prindërit, qoftë duke sjellë prindërit dezinfektues në shkollë. SBASHK-u është kundër iniciativave të tilla sepse në këtë situatë të rënduar sociale e ekonomike nuk është e drejtë të ngarkohen edhe më shumë apo të vihen një pjesë e tyre në pozitë të keqe para të tjerëve ngase nuk kanë mundësi të jenë pjesë e këtij aktiviteti, të cilin SBASHK-u kërkon të ndalet dhe kërkesat e shkollave në rrethanat e reja të sigurohen nga buxheti shtesë prej 9.5 milionë, që ka ndarë Qeveria e Kosovës. SBASHK-u edhe në këtë takim ka përkrahur deklaratimet e MASH-it dhe Qeverisë për sigurimin e një fondi për pagesën gjatë kohës së pandemisë për mësuesit e sëmurë rëndë.



Duke shprehur vullnetin dhe dëshirën e sinqertë që viti i ri shkollor të nis së mbari dhe që institucionet arsimore të jenë plotësisht të përgatitura në plotësimin e udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik në përpjekje për ruajtjen e shëndetit të nxënësve dhe personelit arsimor SBASHK-u u drejtohet Qeverisë dhe MASH-it me zërin e punëtorëve arsimor që nisja e vitit të ri shkollor të shtyhet për 10 ditë.

Kryesia, Këshilli Drejtues dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve pas shumë diskutimeve dhe bazuar edhe në komunikimin gjatë gjithë kohës me veprimtarët sindikal nxjerr konkluzionet me të cilat publikisht njofton Qeverinë,

Bashkëpunim korrekt mes SBASHK-ut dhe MASH-it

## Tema të bashkëbisedës çështjet aktuale në arsim

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë pasur komunikim të vazhdueshëm nga larg me Ministrin Likaj dhe zyrtarë të tjerë të MASH duke bashkëbiseduar për aktualitetin në arsim dhe për kërkesat legjitime të anëtarësisë së SBASHK-ut. Po ashtu janë zhvilluar edhe takime me Ministrin Likaj dhe anëtarë të kabinetit të tij.

Gjatë këtij komunikimi dhe gjatë takimeve të mbajtura Ministri Likaj ka informuar SBASHK-un për gjithë angazhimet në MASH për fillimin vitit të ri shkollor, duke përmendur edhe opsionet e përgatitura nga grupet punuese. Po ashtu është bashkëbiseduar edhe për kërkesat e anëtarësisë që kanë të bëjnë me kolegët tanë që kanë 180 kredi, për Kontratën e Re Kolektive të Arsimit, për angazhimet që të gjendet një zgjidhje e

MASH-in dhe gjithë opinionin:

1. Të pajisen shkollat me dezinfektues,
2. Të caktohen persona përgjegjës, por jo mësimdhënësit, për matjen e temperaturës së nxënësve,
3. Të ketë personel mjekësor kujdestar së paku në shkollat që kanë më shumë se 500 nxënës,
4. Të sigurohen maska dhe mjete mbrojtëse për punëtorët arsimor,
5. Të ketë lista të mësimdhënësve rezervë,
6. Të lëshohen vendime për lirimin e përkohshëm nga procesi mësimor të punëtorëve arsimor të sëmurë dhe ata të vazhdojnë të marrin paga gjatë gjithë kohës së pandemisë,
7. Të krijohen mundësi për kryerjen e testit për Covid-19 të personelit arsimor,
8. E-shkollori dhe nisma për ditarët digjital të implementohet pas pandemisë Covid-19.

pranuar për kolegët tanë të sëmurë rëndë, për nisjen e ciklit të ri të trajnimeve nga larg dhe për çështje të tjera në shërbim të anëtarësisë.



Shumë nga çështjet aktuale janë debatuar edhe në

takimin më 10 gusht mes Ministrit Ramë Likaj, shefit të kabinetit të tij Gëzim Berisha dhe kryetarit të SBASHK-ut Rrahman Jasharaj. Duke analizuar bashkërisht fillimin e vitit të ri shkollor Ministri Likaj ka treguar për tri versionet e përgatitura. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj në këtë takim është shprehur se cili do vendim lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor nuk është i lehtë dhe se kërkon angazhimin, jo vetëm të MASH-it, DKA-ve dhe SBASHK-ut, por edhe të gjithë institucioneve qendrore e lokale. Mendojmë se duhet zhvilluar një debat edhe në Parlamentin e Kosovës në mënyrë që të nxjerrën ide

SBASHK në takimin e organizuar me institucionet qendrore dhe DKA-të

## U prezantuan qëndrimet e anëtarësisë lidhur me vitin shkollor

MASH kishte organizuar një takim me pjesëmarrjen e zv/kryeministrit Besnik Tahiri, Ministrit Ramë Likaj, sekretarit të përgjithshëm Agim Bërdyna, kryetarit të Asociacionit të Komunave, kryetarit të DKA-ve Besim Avdimetaj bashkë me kolegët e tij nga e tërë Kosova, kryetarit të SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj. Në hapje të këtij takimi në ambientet e hotelit "Emerald", sekretari i përgjithshëm në MASH, Agim Bërdyna ka përshëndetur zv/kryeministrin Tahiri, ministrin Likaj, kryetarin e Asociacionit të komunave, atë të DKA-ve dhe kryetarin e SBASHK-ut dhe pas kësaj ka kujtuar temat e debatit.



Ministri Likaj ka prezantuar angazhimet e bëra në MASH lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor duke

dhe të caktohen detyra konkrete për të gjithë “, është shprehur Jasharaj duke përsëritur kundërshtimin ndaj vendimit të Qeverisë për shkurtim të buxhetit për MASH-in me rastin e rishikimit të Buxhetit të Kosovës. Në këtë takim të dy palët janë pajtuar që të formohen komisionet që do të negociojnë tekstin e Kontratës së re Kolektive në mënyrë që pastaj ajo të nënshkruhet nga MASH-i dhe SBASHK-u. Po ashtu të dy palët janë pajtuar që bashkërisht të angazhohen për të gjetur zgjedhjen më të mirë të mundshme lidhur me punëtorët e arsimit që janë me sëmundje të rënda.

cekur edhe të tri versionet, që janë bërë publike. Ai ka kërkuar diskutim të lirshëm dhe mendime konkrete nga drejtorët e DKA-ve. Në fjalën e tij zv/kryeministri Tahiri ka deklaruar se Qeveria do të përkrah MASH-in dhe institucionet tjera në angazhimet për fillim të mbarë të vitit të ri shkollor.

Kryetari i SBASHK-ut ka përcjellë në këtë takim qëndrimet që janë marrë në takimin me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve. që u zhvillua po të martën në orët e paradites. Ai ka deklaruar para përfaqësuesve të Qeverisë dhe institucioneve tjera se SBASHK-u ka mbajtur konsultime të vazhdueshme me kolegët tanë kudo në Kosovë e po ashtu po sot ka mbajtur takim me Këshillin Drejtues dhe me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve dhe se është vendim nga ky takim që SBASHK nuk do të pranojë që të shtohet norma e punës së mësimdhënësve, do të përcjell nga afër përgatitjen në institucionet arsimore dhe kërkon që kolegët tanë me sëmundje të rënda të lirohen nga procesi mësimor dhe të vazhdojnë të marrin paga e në vene të tyre të angazhohen mësimdhënës të tjerë nga lista e personelit rezervë.

SBASHK-u ka vazhduar takimet me përfaqësues të institucioneve

## Takime të ndara me zv/kryeministrin Selmanaj dhe zv/ministrin Rexhaj

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri në kuadër të komunikimit dhe takimeve me përfaqësues të lartë të institucioneve të Republikës së Kosovës kanë pasur takime të ndara me zv/kryeministrin në Qeverinë e Kosovës, Driton Selmanaj dhe me zv/ministrin e MASH-it Xhavit Rexhaj.

Në takimin me zv/kryeministrin Selmanaj dhe anëtarët e kabinetit të tij, kryetari i SBASHK-ut Jasharaj dhe koordinatori Ymeri kanë informuar atë lidhur me angazhimet dhe përkushtimin e SBASHK-ut në shërbim të arsimit dhe për vullnetin e shprehur të mësimdhënësve për të zhvilluar procesin mësimor në institucione arsimore me respektimin e plotë të Rregullave të përcaktuara nga Instituti i Shëndetit Publik dhe MASH-i.



Duke përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe përkushtimin në shërbim të arsimit dhe realizimit të kërkesave të anëtarësisë, zv/kryeministri Selmanaj ka deklaruar se Qeveria do ta përkrah vazhdimisht MASH-in në realizimin e objektivave në shërbim të

arsimit dhe ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim. Zv/kryeministri ka shtuar se institucionet do të vazhdojnë bashkëpunimin me SBASHK-un dhe sindikatat tjera në shërbim të dialogut të mirëfilltë social dhe angazhimit të përbashkët për të realizuar kërkesat legjitime të të punësuarve në arsim dhe në sektorët tjerë.

Po të njëjën ditë kryetari i SBASHK-ut Jasharaj dhe koordinatori Ymeri janë takuar me zv/ministrin e MASH, Xhavit Rexhaj dhe anëtarë të kabinetit të tij. Temë kyçe e bashkëbisedës në këtë takim ka qenë çështja e fillimit të vitit të ri shkollor. Zv/ministri Rexhaj ka treguar për gjithë punët dhe angazhimet që janë bërë në MASH për të nisur me vitin e ri shkollor.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut në këtë takim kanë treguar se në komunikimin dhe takimet e vazhdueshme nga larg me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve dhe me anëtarë të Këshillit Drejtues është vërejtur gatishmëria e shumicës së punëtorëve të arsimit që viti i ri shkollor të nis dhe të vazhdojë në institucionet arsimore, por është kërkuar arsyeshëm që të merren masat e duhura për sigurinë e nxënësve dhe punëtorëve arsimor. Në këtë takim është bashkëbiseduar edhe për çështje të tjera aktuale në arsimin e Kosovës.

## SBASHK-u vazhdon të realizojë kërkesat e anëtarësisë U fillua me ciklin e ri të trajnimeve nga larg

Koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri duke iu përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve në takimin me Këshillin Drejtues dhe me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve, ka treguar për gatishmërinë e tij dhe të stafit qendror lidhur me nisjen e ciklit të trajnimeve nga larg.





Duke u nisur nga kjo e pasi kishin arritur kërkesat e para për të filluar me ciklin e ri të trajnimeve kjo e shtunë, më 29 gusht shënoi nisjen e trajnimeve në "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik", me trajnerin Sami Shala, "Mësimdhënia e gjuhës shqipe dhe letërsisë për ciklin fillor dhe të mesëm" me trajnerin Mentor Mani,

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës



trajnimi "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" me trajnerin Blendor Shatri dhe trajnimin "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajnerin prof dr. Hysen Sogojeva.



Në fillimet e këtyre trajnimeve me pjesëmarrësit kanë bashkëbiseduar kryetari Rrahman Jasharaj, Koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me anëtarë të stafit dhe kryetari i nivelit sindikal komunal për Prishtinën, Ahmet Pllana.




Kryetari i SBASHK -ut Rrahman Jasharaj ka falënderuar koordinatoren Ymeri dhe stafin për angazhimet dhe arritjet e shumta në shërbim të anëtarësisë. Ai ka falënderuar edhe trajnerët dhe ka përgëzuar pjesëmarrësit për pjesëmarrje në këtë aktivitet. Pjesëmarrësit i ka përshëndetur edhe kryetari i nivelit sindikal komunal Ahmet Pllana, i cili pastaj ka shprehur respekt të lartë për angazhimet e kryetarit dhe stafit qendror në shërbim të anëtarësisë. Koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri u është përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve dhe u ka kujtuar atyre çështje nga rregullat lidhur me trajnimet dhe pjesëmarrjen për katër ditë në këtë aktivitet.



U mbajt takim nga larg me partnerët për arsim më të mirë

## U debatua për gatishmërinë e e mësimdhënësve për fillimin e vitit të ri shkollor

Duke vazhduar me takimet nga larg në kuadër të debatimit për temat me rëndësi për arsimin në Kosovë, GIZ në bashkëpunim me SBASHK-un dhe MASH-in kanë mbajtur takimin e radhës me titullin “Gatishmëria e mësimdhënësve për fillimin e vitit të ri shkollor sipas skenarëve të ofruar nga MASH”.



Në këtë takim ishin ftuar një numër i konsideruar i punëtorëve të arsimit, kryetarë të nivelit komunal sindikal, drejtorë të disa DKA-ve dhe përfaqësues të OJQ-vë, që janë partner të fushatës për arsim më të mirë.




Pjesëmarrësve të këtij takimi u janë drejtuar Diellza Kukaj, Këshilltare e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Rrahman Jasharaj, kryetar i SBASHK-ut dhe drejtori i DKA-së së Malishevës dhe nënkryetar i Asociacionit të DKA-ve të Kosovës, Blerim Thaçi.


Përfaqësuesja e MASH-it ka dhënë informacione për angazhimet e MASH-it lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. Pas kësaj Ministri i MASH z. Ramë Likaj është kyçur në bashkëbisedë dhe duke iu drejtuar pjesëmarrësve ka informuar në

detaje për angazhimet dhe është shprehur se po këtë ditë do të mbahet një takim i jashtëzakonshëm dhe mase edhe do të shtyhet fillimi i vitit të ri shkollor.




Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj u është drejtuar pjesëmarrësve duke treguar për gjithë angazhimet e shumta të SBASHK-ut në shërbim të arsimit. Ai ka përshëndetur kreun e GIZ-it z. Boris duke e falënderuar për gjithë kontributin në shërbim të arsimit në Kosovë dhe për bashkëpunimin me SBASHK-un. Jasharaj është deklaruar se në komunikimin dhe takimet me organet përgjegjëse të SBASHK-ut është vlerësim i përgjithshëm se institucionet arsimore nuk janë përgatitur ashtu si janë kërkesat e Institutit të Shëndetit Publik dhe kërkesat nga dokumentet e botuara të MASH-it për fillimin e vitit të ri shkollor. Jasharaj ka thënë se do t'i drejtohen prandaj publikisht institucioneve të shtetet që të shtyhet për disa ditë fillimi i vitit të ri shkollor.





Drejtori i DKA-së së Malishevës dhe nënkryetar i Asociacionit të DKA-ve të Kosovës, Blerim Thaçi duke folur në emër të DKA-ve ka theksuar se janë bërë përgatitje, por ai ka shtuar se, mbase, duhet vepruar sipas apelit të SBASHK-ut duke shtyrë fillimin e vitit të ri shkollor për disa ditë me qëllim që të bëhen gjithë përgatitjet e duhura.



Pas kësaj është hapur debat dhe pjesëmarrësit kanë dhënë mendimet e tyre e po ashtu u janë drejtuar me pyetjet konkrete panelistëve të kësaj takimi nga larg.